



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1226/9 prot.

Tiranë më 22.07.2026

REKOMANDIM

Nr. 46, datë 22.07.2026

PËR KONTROLLUESIN “ORACLE LAW GLOBAL ALBANIA SHPK”

Në mbështetje të neneve 81-84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të “Oracle Law Global Albania Shpk” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 108, datë 18.05.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit “*Oracle Law Global Albania SHPK*” (në vijim “Kontrolluesi”) me objekt:

- *Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi B.M, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të Ligjit Nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi procesverbalet e konstatimeve, provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, si dhe relacionin e përfundimit të hetimit administrativ, vëren se:

1. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e subjektit të të dhënave z. B.M, nëpërmjet së cilës deklaroi se në cilësinë e ish punonjës të Kontrolluesit, në ambientet e brendshme të tij, ka instaluar dhe përdorur sistem video-survejimi (*kamera sigurie*), pamje filmike të cilat monitorojnë edhe tavolinën e punës së punonjësve (*individ i përfshirë edhe ankuesi*). Referuar ankesës, ankuesi pretendon se si ish-punonjës i Kontrolluesit, nuk është informuar për qëllimin dhe bazën ligjore tëurvejimit me kamera CCTV, nuk janë vendosur tabela informuese sipas kërkesave

të ligjit, nuk është bërë transparente periudha e ruajtjes së të dhënave, si dhe nuk i është dhënë akses në të dhënat që i përkasin.

2. Në kuadër të verifikimit të deklarimeve/prendimeve të parashtruara nga ankuesi në ankesë, Zyra e Komisionerit ka dalë me Urdhër nr. 108, datë 18.05.2026, për kryerjen e hetimit administrativ pranë Kontrolluesit “*Oracle Law Global Albania SHPK*”.

Grupi i inspektimit është paraqitur në datën 20.05.2026, në adresën e zyrave të Kontrolluesit, duke i bërë me dije administratorit të tij z. Kristi Vako, qëllimin/objektin e hetimit, e njëkohësisht duke i vënë në dispozicion urdhrin e hetimit administrativ.

Në zbatim të kërkesave të urdhrit të hetimit, përfaqësuesit të Kontrolluesit ju kërkua akses në sistemin elektronik ku mbahen/ruhen pamjet filmike CCTV, kqyrja e ambienteve të brendshme të pozicionimit të kamerave, informacion/dokumentacion në lidhje me instalimin e kamerave, si dhe sqarime në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë.

3. Nga verifikimi në vend, rezulton se Kontrolluesi ka instaluar sistemin e video-survejimit (CCTV) përveç korridoreve edhe në ambientet e punës, në një pozicionim të tillë që mundëson monitorimin e vazhdueshëm të posteve të punës së punonjësve, në kundërshtim kjo me nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

Ky pozicionim i kamerave bie ndesh edhe me germën “a” të pikës 5 të nenit 2 të Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit” (në vijim “Udhëzimi nr. 3”), sipas së cilës pozicioni i kamerave duhet të jetë në përputhje me qëllimin për të cilin përdoren dhe nuk duhet të mundësojë përftimin e imazheve nga mjedise që nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

Po ashtu, referuar germës “b” të pikës 3 të nenit 2 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, përdorimi i një sistemi CCTV duhet të justifikohet nga një nevojë e veçantë për mbrojtjen e të drejtave të kontrolluesit ose të personave të tretë, si dhe sipas germës “ç” të së njëjtës pikë, përpunimi lejohet vetëm kur qëllimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera më pak ndërhyrëse.

Në këto kushte, monitorimi i drejtpërdrejtë i posteve të punës së punonjësve përmes sistemit CCTV tejkalon qëllimin e garantimit të sigurisë së ambienteve dhe përbën një ndërhyrje të pajustificuar në privatësinë e tyre.

Po ashtu, Konstatohet se pamjet filmike ruhen në sistemin elektronik të video survejimit CCTV përtej afatit 30 ditor, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6, të Ligjit, si dhe me nenin 3 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat e përpunuara dhe të ruajtura përmes sistemit CCTV, si pamjet video, imazhet dhe të dhënat e zërit (audio), konsiderohen të dhëna personale konform ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, e si të tilla

përpunimi i këtyre të dhënave duhet të kryhet në përputhje me parimet e përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit, si ligjshmëria, drejtësia, transparenca, kufizimi i qëllimit, minimizimi i të dhënave, saktësia, kufizimi i afatit të ruajtjes, si dhe integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave.

Vendosja e kamerave në postet e punës së punonjësve, sjell përpunim të panevojshëm, pasi Kontrolluesi nuk ka arritur në asnjë moment të provojë se përmbush një nga kriteret e parashikuara në pikën 10 e vijues, të Udhëzimit nr. 11 datë 08.09.2011 të Komisionerit “Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar, në të cilin parashikohen në mënyrë shteruese rastet specifike kur kamerat e vëzhgimit mund të drejtohen në vendin e punës së punonjësve.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka detyrimin që çdo proces përpunues ta mbështesë në një kriter të qartë ligjor, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit. Përpunimi i të dhënave pa bazë ligjore, përbën përpunim të paligjshëm të të dhënave personale. Ky proces përpunimi nëpërmjet sistemit CCTV cenon të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave.

4. Ndërsa, në lidhje me pikat e tjera të kërimit të parashtruara në ankesë nga ankuesi (si: *nuk është informuar për qëllimin dhe bazën ligjore tëurvejimit me kamera CCTV nga Kontrolluesi, në ambientet e këtij të fundit nuk janë vendosur tabela informuese sipas kërkesave të ligjit, nuk është bërë transparente periudha e ruajtjes së të dhënave (pamjeve filmike), si dhe nuk i është dhënë akses në të dhënat që i përkasin*), nuk janë konstatuar shkelje në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në vijim të procesit administrativ, bazuar në nenet 87-89 të KPA, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë masa duke caktuar/njoftuar se në datën 18.06.2026 ora 12:00, pranë ambienteve të institucionit, do të zhvillohet seanca dëgjimore në prezencë të Kontrolluesit Oracle Law Global Albania Shpk, seancë e cila u shty me kërkesën e këtij të fundit, duke u zhvilluar më datë 19.06.2026 ora 13:00.

- Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Kontrolluesi depozitoi akte shkresore, si vijon:
 - Parashtrime (administruar me tonën me nr. 1226/8 prot., datë 19.06.2026);
 - Tabela e informimit tëurvejimit me kamera e përditësuar;
 - E-mail i datës 18.06.2026 e Kontrolluesit drejtuar stafit të tij;
 - Procesverbal i mbajtur nga Kontrolluesi për heqjen e kamerave e datës 18.06.2026;
 - 6 foto të shkrepura me aparat celular të marra nga ambientet e brendshme të zyrave të Kontrolluesit;
 - Kopje e mjetit të identifikimit.

- Kontrolluesi, në mënyrë të përmbledhur parashtroi se: *“...Për qëllime të sigurisë së ambienteve të tij, mbrojtjes së pasurisë dhe sigurisë së personave (punonjësve dhe vizitorëve), Kontrolluesi ka pasur të instaluar në ambientet e zyrës një sistem video-survejsimi...Përpunimi është mbështetur në bazën ligjore të interesit legjitim të Kontrolluesit (neni 6 i ligjit nr. 124/2024), interes që konsiston në sigurinë e ambienteve, parandalimin dhe dokumentimin e incidenteve të sigurisë dhe mbrojtjen e personave e pasurisë. Qëllimi i sistemit ka qenë mbikëqyrja e sigurisë së hapësirës së zyrës në tërësi dhe jo monitorimi i punonjësve apo i veprimtarisë së tyre...Kontrolluesi është i ndërgjegjshëm se survejsimi në ambiente ku punonjësit kryejnë veprimtarinë e tyre i nënshtrohet një vlerësimi më të rreptë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Pikërisht në zbatim të këtyre parimeve, Kontrolluesi ka ndërmarrë rishikimin e plotë të sistemit dhe heqjen e të gjitha kamerave (shih Seksionin IV të kësaj parashtrese), duke adresuar në mënyrë të plotë çdo shqetësim eventual lidhur me proporcionalitetin e pozicioneve të veçanta...Kontrolluesi shpreh gatishmërinë e tij të plotë për bashkëpunim të mëtejshëm me Zyrën e Komisionerit dhe e fton grupin e inspektimit të kryejë, në çdo kohë, çdo verifikim apo inspektim të mëtejshëm në ambientet e tij, në funksion të zgjidhjes së plotë dhe transparente të çështjes...”*.

Pas përfundimit të seancës dëgjimore, administrimit të akteve shkresore të depozituara nga Kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vëren se njoftimi elektronik nëpërmjet së cilit Kontrolluesi ka njoftuar stafin për heqjen e kamerave, është me të meta, e cila konsiston në mungesën e përcaktimit të bazës ligjore e cila ju njeh të drejtat/detyrimet subjekteve të të dhënave/kontrolluesit/përpunuesit, e për këto arsye, çmoi të vijojë verifikimin e pretendimeve të Kontrolluesit në terren.

- Nga sa më sipër, grupi i inspektimit është paraqitur pranë ambienteve të Kontrolluesit më datë 01.07.2026, prezencë nga e cila është hartuar në vend procesverbali (një kopje e së cilit i është lënë edhe Kontrolluesit), ku në përmbajtje të tij, ndër të tjera, pasqyrohet: *“...Kontrolluesi ka çmontuar të gjitha kamerat fizike të vendosura në ambientet e brendshme të tij, përfshirë edhe në zyrat e punonjësve të tij (bazuar ky fakt në 7 fotot e marra nga inspektorët në kohë reale, ku vërtetohet mungesa e kamerave aktualisht në pozicionet e tyre fillestare)...”*.

Në mbështetje të kronologjisë së veprimeve të ndërmarra në kuadër të trajtimit të ankesës së ankuesit z. B.M dhe verifikimeve të parashtruara në të, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e inspektimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij në marrjen e masave në mënyrë të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve, nenet 6, 7, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 6 dhe 7 të ligjit nr. 124/2024 dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, të ketë në vëmendje që, në rast se vendos të instalojë sërish një sistem video-survejimi (CCTV), përdorimi i tij të jetë në përputhje me parimet e dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale.
2. Kontrolluesi, në zbatim të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, të ketë në vëmendje që, në rast se vendos të instalojë sërish një sistem video-survejimi (CCTV) pozicionimi i kamerave të jetë në përputhje me qëllimin për të cilin përdoren dhe të mos mundësojë përfitim të imazheve nga mjedise që nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.
3. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - a. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 më sipër;
4. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të mos zbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 22.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi